

KUMTESË PËR PUBLIKUN

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës informon se gjatë vitit 2025 janë shqiptuar gjoba për shkelje të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe të Ligjit për Ndalimin e Praktikave të Padrejta Tregtare, në vlerë të përgjithshme prej 53.044.555,00 denarë.

Me këto sanksione, Komisioni dërgon një mesazh të qartë dhe të pa ekuivok se kartelet, marrëveshjet e ndaluara, abuzimi me pozitën dominuese, përqendrimet e paparaqitura dhe praktikave të padrejta tregtare nuk do të tolerohen. Gjobat kanë një rol të theksuar parandalues dhe paraqesin një mekanizëm efikas për të penguar shkeljet e ardhshme të rregullave të tregut.

Komisioni do të vazhdojë me mbikëqyrje aktive dhe zbatim të qëndrueshëm të kompetencave ligjore, me qëllim të sigurimit të kushteve të drejta dhe transparente në treg, trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë, si dhe mbrojtje efektive të konkurrencës dhe interesave të konsumatorëve.